

Prof. Dr. Marenglen VERLI

INTERESIMI I SHTETIT SHQIPTAR PËR SHQIPTARËT NË JUGOSLLAVI NË VITET 20-30 TË SHEK. XX*

Periodha e viteve 20-30 të shek. XX dhe veçanërisht vitet 1925-1939, janë të lidhura aq fort me emrin e Ahmet Zogut, saqë rëndom ato vite quhen “koha e Zogut”. Ky emërtim i përdorur, sipas rastit, me sens negativ ose pozitiv, ka ardhur gjithsesi, i natyrshëm për shkak të gjurmëve që personaliteti dhe veprimtaria e tij e spikatur lanë në këtë hark kohor, veprimtari e cila konsiston në konfirmimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe me hapat për konsolidimin e shtetit shqiptar.

Në kuadër të veprimtarisë së gjithanshme të një shteti, të marrëdhënieve të tij ndërkombëtare e të brendshme, në përpjekjet e tij për sigurimin e qetësisë e të rendit, për zhvillimin e ekonomisë, të arsimit e të kulturës kombëtare, mandej të përkrahjes së bashkëkombësve që jetojnë në trevat e veta jashtë shtetit kombëtar, si edhe të diasporës, etj., roli i elitës drejtuese të një vendi dhe i figurës qendrore të saj është i padiskutueshëm. Në rastin e Shqipërisë së asaj kohe, aq më tepër, kjo ka qenë një e vërtetë absolute.

Për sa i takon thelbit të temës së kësaj kumtese shtjellimi kërkon shtrimin paraprakisht të disa pyetjeve, që hapin disa pista paralele argumentimi:

* Kumtesë e mbajtur më 1 shtator 1928 në Tiranë, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: “Monarkia shqiptare 1928-1939”.

Së pari, cilat ishin raportet e A. Zogut me elitën politike kosovare në periudhën e përpjekjeve të tij për marrjen dhe konsolidimin e pushtetit, por edhe më vonë deri në vitin 1939?

Së dyti, në kuadrin e politikës së jashtme e të brendshme të A. Zogut, si trajtoheshin dhe ç'vend zinin shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi?

Mund të shtrohen edhe pyetje të tjera por mendoj se, për përmatat e një kumtese, përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve është e mjaftueshme për të argumentuar qëndrimin e shtetit shqiptar të drejtuar nga A. Zogu.

Dihet se A. Zogu kishte qenë në mbështetje të pavarësisë së Shqipërisë që nga viti 1912¹. Në përkrahje aktive apo pasive ndaj qeverisë së I. Qemalit e më pas të V. Vidit, ai u ndodh përkrah përfaqësuesve të elitës politike kosovare të emigruar nga Kosova e më gjerë, e cila gjithashtu synonte dhe u aktivizua për krijimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, duke mos reshtur edhe përpjekjet për korrigjimin e vendimeve arbitrare të Konferencës së Londrës të viteve 1912-1913 dhe, pas Luftës së Parë Botërore, të Konferencës së Paqes së Parisit². Në këtë periudhë, veçanërisht nga dhjetori i vitit 1918 deri nga fundi i vitit 1920, në politikën shqiptare problemet dhe konfrontimet ishin midis lobeve pro italiane dhe pro ballkanike, që anonin përkatësisht nga opioni i protektoratit ose i pavarësisë. Gjithsesi në Kongresin e Lushnjës dhe në qeverinë e dalë prej tij, A. Zogu dhe grupimi më racional i elitës politike kosovare në Shqipëri, përfaqësuar nga Hoxha Kadri Prishtina (Kryetari i Komitetit "MKK") etj., ishin përkrah njeri tjetrit. Madje A. Zogu dhe K. Prishtina u bënë pjesë e kabinetit të zgjedhur në Lushnjë³.

Diferencat dhe kundërvënia, që do të prishnin raportet e sipërpërmendura, erdhën më pas, gjatë agravimit të situatës dhe ballafaqimeve të ashpra politike të viteve 1921-1924 në luftën për pushtet.

1 *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, vëll. III, Tiranë, 2007, f. 67; B. Fisher, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, 1996, f. 16, 17, 21; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, 2000, f. 123; V. Duka, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 2007, f. 73, 75, 86 etj.

2 *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e përm., vëll. III, f. 84; K. Ulqini, *Shkodra dhe Komiteti MKK*, në vëllimin "Komiteti "MKK" (Përmbledhje kumtesash)", Tiranë 2002, f. 108; P. Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Tiranë 1998, f. 34; L. Culaj, *Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës, 1918-1924"*, Prishtinë 1997, f. 107, etj.

3 *Po aty*; *Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës*, Tiranë 1974, f. 98; M. Verli, *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate*, Tiranë, 2007, f. 85, 111; etj.

Problemet e periudhës 1921-1924, pozicionimi dhe ripozicionimi i individëve në grupime tepër fluide, janë të njohura, përplasjet midis pozitës dhe opozitës sipas parametrave ballkanike, ku likuidimi i kundërshtarëve realizohej me çdo mjet, gjithashtu janë të njohura ⁴. Në dhjetorin e vitit 1924, në fund të periudhës në fjalë, një pjesë e madhe e elitës politike kosovare të vendosur në Shqipëri për shkak të kundërvënies, ndaj grupimit të A. Zogut, ndodhej para dy alternativash: të emigronte ose të nënshtrohej. Kushdo që ndoqi një rrugë të tretë, atë të qëndrësës së mëtejshme, kur kjo ishte një gjë e pamundur, shumë shpejt u likuidua. Janë të njohura faktet që dëshmojnë për ndërprerjen e veprimtarisë së Komitetit “MKK”, personalitetet kryesore të të cilit ishin rreshtuar përkrah opozitës në vitet 1921-1924 dhe kishin mbështetur qeverinë e F. Nolit, mandej likuidimet e figurave të tilla si Bajram Curri dhe më pas Hasan Prishtina etj., por shumë prej tyre kishin luftuar me mënyra të ngjashme madje H. Prishtina edhe pas vitit 1924 nuk i kishte ndaluar përpjekjet për likuidimin e A. Zogut dhe destabilizimin e regjimit të tij ⁵. Duhet theksuar se likuidimi i H. Prishtinës u krye në momentin kur marrëdhëniet italo-shqiptare ishin në acarim të plotë dhe ai llogaritej në Romë si zëvendësues i mundshëm i A. Zogut në Tiranë. Por që synimi kryesor i A. Zogut ishte stabilizimi i pushtetit dhe jo thjesht antipatia apo armiqësia pa fre për individë të caktuar provohet jo vetëm nga qëndrimi i tij ndaj lobit proitalian (rastet e M. Libohovës, Sh. Vërlacit, H. Prishtinës, etj.), por edhe nga veprimet ndaj lobit projugosllav në Shqipëri. Çështje si ajo e Gjurashkoviçit, apo shmangia nga pozicionet e rëndësishme e kunatit të tij Ceno beg Kryeziut, në mos edhe likuidim apo së paku mospengimi i likuidimit të tij nga lobi proitalian në tetor të vitit 1927, sikurse mendojnë studiues të ndryshëm, janë dëshmi për këto ⁶.

Edhe pse duket në mjaft raste sikur qëroheshin llogari të vjetra, në vitet 1925-1939 politika e A. Zogut synonte në radhë të parë

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Tiranë 2007, f. 176-187; 213-245; S. Vllamasi, *vep. e përm.*, f. 190-219; 309-429; *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar në lëvizjen kombëtare e demokratike shqiptare 1908-1933*, Tiranë, 1920-1924; etj.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e përm. f. 286, 306-308; S. Vllamasi, *vep. e përm.*, f. 451-460; K. Nuro, N. Bata, *Hasan Prishtina 1908-1934 (Dokumente)*, Tiranë 1983, f. 180 etj.

⁶ *Po aty*; J. Osmani, *Vrasja e Ceno beg Kryeziut në Pragë*, Prishtinë 1998, etj.

konsolidimin e regjimit të tij, që do të thoshte për situatën në ato vite, konsolidimin e shtetit të brishtë shqiptar. Në kuadër të kësaj politike, Shqipëria u bë strehë për emigracionin politik kosovar të çdo niveli gjatë viteve 1925-1939. (Përmendim p.sh. rastin e 3 klerikëve katolikë të arratisur nga Jugosllavia, E. Kurtit, Gj. Bisakut, L. Gashit, pas masakrimit atje të Atë Shtjefën Gjeçovit, si edhe dërgimit prej tyre më 1930 në adresë të sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Erik Drymondit, të një promemorieje të detajuar për gjendjen e rëndë të shqiptarëve atje, etj.)⁷. Në këtë kuadër personalitete të ndryshme nga Kosova, që plotësonin kriteret e cilësive dhe natyrisht, që ishin besnikë e dëshironin të shërbenin në administratën e Shqipërisë, u emëruan në poste të ndryshme civile e ushtarake (Mund të evidentohen rastet e Sali Vuçiternit, nipit të I.Boletinit, Tafil Boletinit, etj., të cilët patën detyra të ndryshme me rëndësi në administratën shqiptare. Të tjerë si Ali Riza Kosova, Hysni Peja, Mehmet Delia etj. patën në detyra po kaq të rëndësishme në ushtrinë e xhandarmërinë shqiptare, etj.)⁸. Gjithnjë në këtë kuadër personalitete të elitës politike shqiptare të Kosovës që jetonin në Jugosllavi, patën mbështetje në mënyra të ndryshme nga Tirana zyrtare. (Rasti i Ferhat Dragës që familjarisht ishte i garantuar se do të kishte përkrahjen e Shqipërisë, madje edhe financohej për të mos u penguar në përpjekjet për mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në Jugosllavi. Le të shtojmë edhe një fakt që lidhet me F. Dragën. Ndërkohë që raportet e A. Zogut me Mustafa Qemal Ataturkun nuk ishin të ngrohta, F. Draga u nxit të shfrytëzonte lidhjet personale për të çuar deri në kabinetin e Ataturkut shqetësimin e shqiptarëve për konventën e njohur turko-jugosllave të shpërnguljes të vitit 1938, me ç'rast u mor prej këtij të fundit premtimi se do të ndikonte që ajo konventë të mos ratifikohet dhe shqiptarët të mos dëmtoheshin prej saj)⁹.

Shembuj të shumtë provojnë se A. Zogu në raportet e tij me elitën politike kosovare u orientua nga strategjia për marrjen dhe ru-

7 T. Abdyli, *vep. e përm.* f. 323; Gj. Bisaku, Sh. Kurti, L. Gashi, *Gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi*, Tiranë 1995.

8 M. Verli, *Nga Kosova për Kosovën (profile bibliografike)*, Tiranë, 2006, f. 11; T. Boletini, *Kujtime*, Tiranë 2003, f. 140-188, etj.

9 *Po aty; AQSh*, Fondi MPJ, viti 1936, dos. 165, fl. 301-305; *Po aty*, viti 1930, dos. 194, fl. 402; shih edhe M. Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, vëll.I, Tiranë 2002, f. 345-354.

ajtjen e pushtetit të tij dhe natyrisht konsolidimit të shtetit shqiptar, të pranuar e të njohur në arenën ndërkombëtare. Rrethanat rajonale e ndërkombëtare të asaj kohe ishin krejtësisht të papërshtatshme që të ndërmerrej ndonjë hap në drejtim të çlirimit të Kosovës e më gjerë dhe të bashkimit me Shqipërinë të viseve shqiptare të aneksuara nga fqinjët më 1913-ën. E vetmja gjë që mund të bëhej ishte të ndërmerreshin hapa në arenën ndërkombëtare, kryesisht indirekte, si edhe hapa diplomatikë e propagandistikë, përkatësisht në drejtim të Beogradit dhe të popullsisë shqiptare në Kosovë e më gjerë, që të frenohej dhuna dhe keqtrajtimi mbi shqiptarët, të mbahej gjallë fryma kombëtare atje dhe të pengohej, sa të ishte e mundur, politika e terrorit, e shpronësimit, e shpërnguljes dhe e kolonizimit sllav të viseve shqiptare, shkurt politika e spastrimit etnik në viset shqiptare. Në këtë kuadër ndoshta do parë edhe zgjedhja nga A. Zogu e emrit “Mbret i shqiptarëve” dhe jo “Mbret i Shqipërisë”, me rastin e krijimit të Mbretërisë Shqiptare në shtator 1928. Por do të duhej përmendur edhe fakti se në gjysmën e dytë të viteve 30, veçanërisht gjatë vitit 1938, vit i cili në arenën ndërkombëtare karakterizohet nga lakimi gjerësisht i çështjes së minoriteteve dhe të drejtave të tyre (Kulmi i trajtimit, pavarësisht nga spekulimet e shteteve fashiste, u bë në mbledhjen e Mynihut), A. Zogu shfrytëzoi edhe interesimin italian për të gjallëruar irredentizmin të shqiptarët dhe i la hapësirë rigjallërimit të Komitetit të Kosovës në Shqipëri, pa llogaritur aktivizimin në këtë drejtim të nëpunësve të tij të besuar me origjinë nga Kosova (Sali Vuçiterni etj.)¹⁰

Synimi për ruajtjen e Kosovës shqiptare, në pritje të koniukturave të favorshme ndërkombëtare, që do të lejonin korrigjimin e padrejtësive të kryera në forumet ndërkombëtare të njohura të viteve para e pas Luftës së Parë Botërore, përcaktuan edhe veprimtarinë diplomatike dhe ekonomike të qeverive shqiptare të viteve 20-30, veçanërisht të periudhës 1925-1939, për të penguar shpërnguljen e shqiptarëve nga viset e veta në Jugosllavi (Këtu do të duhej përmendur veprimtaria e përfaqësive diplomatike shqiptare, veçanërisht në Shkup – kryekonsullata, në Manastir – konsullata, në Beograd – legata, në Selanik –

10 F. Rama, Komiteti i Kosovës në bashkëpunim me organizatat e tjera politike (1925-1939) në vëll. *Komiteti “MKK”, vep. e për.*, f. 129-150; H. Bajrami, *Bedri Pejani*, Prishtinë 1994, f. 32; Po ai, *Rrethanat politike e shoqërore në Kosovë 1918-1941*, Prishtinë 1981; etj.

konsullata, në Stamboll etj.). Gjithashtu, në kuadër të këtij synimi, u ndërmorën hapat për të pranuar e sistemuar në Shqipëri shqiptarët e përtej kufirit që ishin detyruar të emigronin nga Jugosllavia drejt shtetit amë, ndonjëherë edhe për të riorientuar drejt Shqipërisë emigrantët që ishin drejtuar fillimisht në Turqi, ku edhe shkonte, për shumë arsye, që është e pamundur t'i përmendim në këtë kumtesë, rryma kryesore të të shpërngulurve (Midis dy luftërave në Turqi siç dihet, u vendosën së paku 250 000 shqiptarë nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi) ¹¹.

Legjislacioni i viteve 20-30, posaçërisht ai i periudhës pas vitit 1925 (Rregullore për zbatimin e ligjit mbi instalimin e emigrantëve dhe të bujqve në tokat shtetërore, 1925), i detajuar veçanërisht në Ligjin mbi Reformën Agrare të vitit 1930 (dekretuar më 3 maj 1930) dhe në Dekretligjin mbi Vendosjen e Emigrantëve të vitit 1931 (2 shtator 1931)¹² në zbatimin e së cilës (në krye të Drejtorisë për Instalimin e Emigrantëve) u caktua pikërisht një kosovar – Sali Vuçiterna, ish ministër i punëve botore në dy qeveri (Në qeverinë e A. Zogut, 11.05-1.09.1928 dhe të K. Kotës, 5.09.1928-5.03.1930), ishte një dëshmi e synimit dhe përpjekjeve të sipërpërmendura që u konkretizua me sistemimin kryesisht në toka-prona të shtetit shqiptar, në Prefekturat e Fierit dhe Durrësit, të mijëra familjeve nga Kosova e më gjerë (1888 familje), përkatësisht të mbi 20 000 të shpërngulur nga viset shqiptare në Jugosllavi.¹³

Vëmendja ndaj elementit shqiptar në Jugosllavi nuk u shkëput për asnjë moment në vitet 30. Dokumentacioni arkivor i MPJ të Shqipërisë të befason me disa raporte, memo e udhëzime, që datojnë deri

11 *AQSh*, Fondi MPJ, viti 1936, dos. 165, fl. 309-311; *Shih edhe Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1977-1995)*, Prishtinë 1997, f. 41-50; *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Prishtinë, 1992 etj.

12 *Po aty*, Fondi MPB, viti 1932, dos. 538, f. 200-205; *Po aty*, dos. 538/1, fl. 59; *Po aty*, Fondi MPJ, viti 1936, dos. 165, fl. 31. Shih edhe M. Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, vëll. I, Tiranë 2002, f. 350-352.

13 *Po aty*; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Tiranë, 2007, f. 299. Gjithë reforma preku 8109,5 ha tokë, prej të cilave 3411,5 ha nga çifligjet e shtetit dhe 4 638 nga çifligjet private; M. Belegu, *E ashtuquajtura reformë agrare e Zogut dhe dështimi i saj*, në rev. "Studime historike", nr. 1, Tiranë 1978, etj.

në gjysmën e dytë të marsit 1939¹⁴. Pavarësisht nga rreziku i afërt i pushtimit, në këto dokumente vërehet serioziteti dhe impenjimi deri në fund i administratës shtetërore, përkatësisht i MPJ, për të zbatuar politikën e pengimit të spastrimit etnik në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Në këtë kuadër, gjatë viteve 30 nuk mungoi edhe bashkëpunimi i autoriteteve të vendit me anëtarë të Komitetit “MKK”, që rezultoi në kenë zhvilluar veprimtari nga Shqipëria në drejtim të Kosovës. Orientime të MPJ për trupin diplomatik që të hynte në lidhje dhe të përkrahte emigrantët kosovarë, e deri takime të vetë A. Zogut në 1930, 1933 etj. krerë të tyre (Me Bedri Pejanin, ndoshta edhe me Ali Kelmendin etj., apo pritja e një delegacioni të lëvizjes kosovare në 1933 dhe oferta për bashkëpunim “për hir të atdheut” etj.), dëshmojnë rritjen e përpjekjeve të Tiranës zyrtare në periudhën e Mbretërisë në të mirë të çështjes së Kosovës, duke rritur edhe bashkëpunimin me të gjithë elitën politike kosovare brenda ose jashtë Jugosllavisë, që ishte e gatshme për një gjë të tillë¹⁵. Aleanca jo fort e dukshme midis Tiranës zyrtare dhe Komitetit të Kosovës në këtë periudhë vërehet, ndër të tjera, edhe në rolin jo të vogël të së parës për botim në Konstancë (Rumani) të gazetës “Kosova” (nga maji 1932-qershor 1933), si një organ për të sensibilizuar opinionin për çështjen e Kosovës, gjithashtu në aktivizimin e B. Pejanit në delegacionet jozyrtare shqiptare në disa konferenca ballkanike etj.¹⁶

Një drejtim tjetër i veprimtarisë së Tiranës zyrtare në vitet e Mbretërisë në të mirë të çështjes së Kosovës ishte edhe sektori i arsimit. Nuk ishin të pakta, për kushtet e atëhershme të Shqipërisë, përpjekjet për arsimimin jo vetëm të fëmijëve të emigrantëve të ardhur nga Kosova, por edhe të atyre fëmijëve dhe të rinjve kosovarë, që rrezikonin, duke kaluar ilegalisht kufirin, për t’u shkolluar në Shqipëri, ku kishin të garantuar edhe akomodim në konvikte. Ato ishin shumë të pranishëm në Konviktin e njohur “Malet tona” në Shkodër dhe në konviktet e tjera

14 *AQSh*, Fondi MPJ, viti 1936, dos.165, fl.309-311; *Po aty*, viti 1938, dos.107/2, fl.763-766; *Po aty*, fl.796-797; Promemorie e dt.20.3.1939.

15 M. Islami, *Ali Kelmendi*, Tiranë, 2000, f. 149; I. Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930-1941)*, Prishtinë 1997, f. 126; Shih edhe F. Rama, *art. i perm.*

16 F. Rama, *art. i perm.*, f. 145.

të shkollave të ndryshme)¹⁷. Vlerat e kësaj pune të atyre viteve do të dukeshin veçanërisht më pas në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe në periudhën e mëvonshme. Bijtë e Kosovës të arsimuar në vitet 20-30 në shkollat e Shqipërisë do të ishin kultivuesit e arsimit shqip në Kosovë në vitet 1941-1944 dhe pas vitit 1945 dhe, njëherësh, organizatorë të lëvizjes antifashiste, që ndikoi në amortizimin e dhunës serbe mbi popullsinë shqiptare në Federatën e Titos¹⁸.

Politika e sipërpërmendur e diplomacisë shqiptare dhe e dikastereve të tjera të qeverisë shqiptare, e orientuar nga A. Zogu në favor të elementit shqiptar në Jugosllavi, rriti pengesat ndërkombëtare për politikën shovene të Beogradit mbi shqiptarët, uli ritmet e shpërnguljes, sistemoi dhe u krijoi kushte jetese në Shqipëri mijëra familjeve të shpërngulura nga viset e tyre për shkak të dhunës serbe, siguroi arsimimin e dhjetëra e qindra bijve të Kosovës nga brezi i ri me arsim kombëtar, e formatoi Shqipërinë si pikë referimi, si shtet amë, apo si “Piemont”, ide kjo me vlera të pallogaritshme për të ardhmen e Kosovës e më gjerë, rezultati i parë i së cilës u pa qysh në 7 prill 1939, kur shumë kosovarë u treguan të gatshëm të vinin për të luftuar kundër ushtrisë fashiste italiane që sulmoi Shqipërinë.

Në përfundim të kësaj kumtese duke iu përgjigjur shkurt dy pyetjeve të shtruara në fillim mund të konkludojmë:

Së pari, raportet e A. Zogut me elitën politike kosovare patën si bosht përpjekjet e tij për marrjen dhe konsolidimin e pushtetit dhe njëherësh të shtetit shqiptar që ai drejtonte, pa ekzistencën e të cilit, sipas shumë diplomatëve e analistëve të ndryshëm shqiptarë ose të huaj, nuk do të ishte e mundur që në situata të favorshme ndërkombëtare, të ndihmohej zgjidhja e drejtë e çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi.

Në këtë kuadër, dora-dorës, me gjithë mundësitë e pakta që kishte në periudhën në fjalë, shteti shqiptar u përpoq të ndikonte për të frenuar politikën e spastrimit etnik në Kosovë dhe në viset e tjera shqip-

17 M. Shatri, *Të dhëna biografike mbi dija veprimtarë të Komitetit “MKK”*, në vëll. “Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (Përmbledhje kumtesash), Tiranë 2004, f. 168.

18 A. Hadri, *Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë*, Prishtinë, 1973; L. Nasi, *Ripushimi i Kosovës*, Tiranë, 1994; Xh. Gjeçovi, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë 1998; M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë 1997 etj.

tare në Jugosllavi, për t'u ardhur në ndihmë familjeve të shpërngulura, për të arsimuar dhe formuar me ide kombëtare elemente të brezit të ri kosovar, si edhe për të kultivuar sa më masivisht në viset shqiptare nën sundimin e huaj ndjenjat më të mira për "shtetin amë" dhe besimin se ai nuk i kishte braktisur.

Prof. Dr. Marenglen VERLI

SUMMARY

THE INTEREST OF ALBANIAN STATE ON ALBANIANS IN YUGOSLAVIA DURING 20-30 OF THE 20th CENTURY

Ahmet Zogu and the most rational group of Kosovar political elite in Albania represented from Hoxha Kadri Prishtina (Head of the Committee for National Defence of Kosova) and others were standing side by side. Furthermore, A. Zogu and K. Prishtina were elected for government cabinet in Lushnja. Differences and confrontation that would break these relations came afterwards during 1921-1924 – struggle for power.

In December 1924, a large number of Kosovar political elite established in Albania because of confrontation to A. Zogu group, found themselves in front of two alternatives: emigrating out or subordination. Anyone who followed a different path or decided for resistance was eliminated very after. Among remarkable personalities, who found this fate was Bajram Curri and later Hasan Prishtina, etc. It should be noted that murder of H. Prishtina was conducted in time of deep tensions in Italian-Albania relations, when Rome was counting on him to potentially succeed Zog in office.

In 1925 to 1939 Albania sheltered Kosovar political expatriates. Many personalities of Kosova, loyal and willing to serve in Albanian administration were appointed in different civilian and military positions (i.e. Sali Vuçiterni nephew of Isa Boletini, Tafil Boletini, etc. who had different important positions in administration). Others like Ali Riza Kosova, Hysni Peja, Mehmet Delia etc. held also very important positions in Albanian army and gendarmerie. Albanian Ministry of Foreign Affairs followed policy against ethnical cleansing of Kosova and other Albanian territories in Yugoslavia. In this view, during 30-s they work closely with members of the Committee for National Defence of Kosova that resulted with Albanian activities in direction of Kosova.